

## ABSTRAKTI

Ky punim i masterit prezanton një analizë të performancës financiare të ndërmarrjeve minerare në Kosovë, me trajtim të veçantë ndërmarrjen Trepça Sh.A., një ndër kompanitë më të mëdha dhe historikisht të rëndësishme në industrinë minerare në rajon. Punimi shqyrton performancën financiare dhe operacionale të ndërmarrjes Trepça Sh.A. në kontekstin e ndryshimeve ekonomike dhe sfidave që has sektori minerar në Kosovë. Studimi përdor një metodologji kuantitative për të analizuar të dhënat financiare për periudhën 2021-2023, duke përfshirë bilancet e gjendjes, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe tregues të ndryshëm financiarë. Analiza financiare synon të identifikojë trendet, të vlerësojë shëndetin financiar të ndërmarrjes dhe të nxjerrë në pah sfidat dhe mundësitë që ndikojnë në performancën e saj.

Nga studimi dalin në pah disa gjetje të rëndësishme. Së pari, ndërmarrja Trepça Sh.A. ka demonstruar një qëndrueshmëri financiare krahas përballimit të sfidave të ndryshme ekonomike duke treguar një menaxhim efikas dhe një përshtatje strategjike ndaj ndryshimeve të tregut. Megjithatë, studimi gjithashtu vëren se ndërmarrja po përballlet me nevojën për modernizim dhe investime në teknologji të reja për të rritur efikasitetin dhe për të garantuar një rritje afatgjatë dhe të qëndrueshme.

Në përfundim, punimi pohon se përmirësimi i performancës financiare dhe operacionale të Trepça Sh.A. është thelbësor për të mbështetur zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ndërmarrja duhet të përqendrohet në strategji të qëndrueshme që synojnë modernizimin, eficiencën e lartë operacionale dhe inovacionin për të përballuar konkurrencën në tregun global të mineraleve dhe për të shfrytëzuar mundësitë e reja për zhvillim të mëtejëm.

Fjalët kyçe: Performanca financiare; Ndërmarrje minerare; Trepça Sh.A.; Modernizim; Inovacio

## ABSTRACT

This master thesis presents an analysis of the financial performance of mining enterprises in Kosovo, with special attention to Trepça J.S.C., one of the largest and historically significant companies in the region's mining industry. The thesis examines the financial and operational performance of Trepça J.S.C. within the context of economic changes and challenges faced by the mining sector in Kosovo. The study employs a quantitative methodology to analyze financial data for the period 2021-2023, including balance sheets, income and expense statements, and various financial indicators. The financial analysis aims to identify trends, assess the financial health of the enterprise, and highlight the challenges and opportunities that influence its performance.

The study reveals several important findings. Firstly, Trepça J.S.C. has demonstrated financial stability while facing various economic challenges, showing effective management and strategic adaptation to market changes. However, the study also observes that the company is encountering the need for modernization and investment in new technologies to increase efficiency and ensure long-term and sustainable growth.

In conclusion, the thesis asserts that improving the financial and operational performance of Trepça J.S.C. is essential to support Kosovo's economic development. The company should focus on sustainable strategies that aim for modernization, high operational efficiency, and innovation to meet the competition in the global mineral market and exploit new development opportunities.

**Keywords:** Financial performance; Mining enterprise; Trepça J.S.C.; Modernization; Innovation